

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 5</i>

27.03.2025

**Komente ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE për Përshtatjet vjetore të të Hyrave
të Lejuara Maksimale për OST/OT**

Mars 2025

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 5</i>

HYRJE

KOSTT me 14 mars 2025 ka pranuar Raportin e Publikuar nga ZRrE për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin relevant tarifar 2025.

KOSTT në vazhdim paraqet komentet ndaj këtij raporti.

1. KOSTOT OPERATIVE

Sa i përket kostove operative KOSTT në vazhdim ka paraqitur komentet lidhur me koston e blerjes së humbjeve në transmetim si dhe koston e shërbimeve ndihmëse.

1.1 Kosto e blerjes së humbjeve në transmetim

Çmimi mesatar i parashikuar i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve i kalkuluar nga ZRrE prej 105.70 €/MWh, nuk rezulton i mjaftueshëm sipas analizave të KOSTT.

Bazuar në realizimin e blerjes së humbjeve në transmetim për muajt janar dhe shkurt 2025, kostoja totale për këta dy muaj ka rezultuar të jetë 4,911,066.39 milionë euro, me çmim mesatar 154.01 €/MWh. Krahasuar me çmimet e ALPEX për të njëjtët periudhë në vitin 2024 – janar 90.47 €/MWh dhe shkurt 74.75 €/MWh – vërehet një tendencë e qartë e rritjes së çmimeve në këtë vit. Si rrjedhojë, ekziston mundësia që edhe muajt në vazhdim të ndjekin këtë trend rritës. Dallimi i përgjithshëm parashikim vs. aktual për dy muajt e parë të vitit 2025 është rreth 1.8 milion Euro më e lartë vlera aktuale sesa parashikimi fillestar.

Prandaj, duke qenë se i kemi në dispozicion vlerat aktuale të çmimeve, sasive, dhe pagesave për muajt janar dhe shkurt të vitit aktual, propozojmë që komplet raporti të përditësohet me këto vlera. Si dhe po të njëjtat të merren parasysh për parashikimin e koston së humbjeve në transmetim për vitin 2025.

Parashikimi i KOSTT për vitin 2025 duke përfshirë realizimet për muajin janar dhe shkurt janë paraqitur në tabelën në vijim, ku çmimi mesatar rezulton 113.14 €/MWh.

Tabela 1. Parashikimi i koston së humbjeve në transmetim për vitin 2025

KOSTT	KEK			Alpex			Total		Mesatar
	MWh	€/MWh	€	MWh	€/MWh	€	MWh	Euro	€/MWh
2025									
Janar	1,359	36.00	48,924	15,974	155.97	2,491,471	17,333	2,540,395	146.56
Shkurt	1,060	36.00	38,160	13,494	172.86	2,332,511	14,554	2,370,671	162.89
Mars	4,061	36.00	146,197	7,265	134.59	977,783	11,326	1,123,980	99.24
Prill	1,886	36.00	67,898	7,182	92.00	660,764	9,068	728,662	80.35
Maj	2,409	36.00	86,712	6,433	82.65	531,700	8,842	618,412	69.94
Qershor	2,299	36.00	82,749	6,018	89.33	537,558	8,316	620,308	74.59
Korrik	2,296	36.00	82,639	7,105	123.09	874,519	9,400	957,158	101.82
Gusht	2,187	36.00	78,744	7,080	123.07	871,283	9,267	950,027	102.52
Shtator	3,833	36.00	137,973	5,188	123.08	638,516	9,020	776,490	86.08
Tetor	5,143	36.00	185,154	5,192	154.41	801,621	10,335	986,775	95.48
Nëntor	3,634	36.00	130,816	9,241	154.25	1,425,474	12,875	1,556,290	120.88
Dhjetor	1,816	36.00	65,366	12,941	153.82	1,990,671	14,757	2,056,038	139.33
Total	32,981	36.00	1,151,333	103,113	137.07	14,133,872	135,094	15,285,205	113.14

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 5</i>

Gjithashtu, për sqarime shtesë në vazhdim është paraqitur parashikimi i ndarjes në % i burimeve të blerjes së humbjeve në transmetim për vitin 2025.

Tabela 2. Parashikimi i ndarjes së burimit të blerjes së humbjeve për vitin 2025

Viti 2025	Blerjet nga KEK	Blerjet nga ALPEX
Janar	7.84%	92.16%
Shkurt	7.28%	92.72%
Mars	35.86%	64.14%
Prill	20.80%	79.20%
Maj	27.24%	72.76%
Qershor	27.64%	72.36%
Korrik	24.42%	75.58%
Gusht	23.60%	76.40%
Shtator	42.49%	57.51%
Tetor	49.77%	50.23%
Nëntor	28.22%	71.78%
Dhjetor	12.30%	87.70%
Total vjetor	26.37%	73.63%

1.2 Kostot e shërbimeve ndihmëse

KOSTT ka vazhduar Marrëveshjen e Kycjes (MK) me RGCE/ENTSO-E nga shtatori 2024 edhe për dy vite të tjera, duke u zotuar se me përgjegjësi dhe në mënyrë profesionale do të përmbushen të gjitha obligimet teknike dhe financiare që dalin nga MK. Siç e dimë kjo marrëveshje i ka mundësuar KOSTT-it të operojë si LFC (Load-Frequency Control) e pavarur. Një nga funksionet bazike që një TSO të operojë si e pavarur është operimi normal i Sistemit brenda standardeve të vendosura nga ENTSO-E, dhe përveç detyrave tjera nënkupton edhe balancimin e sistemit në çdo kohe, pra 24/7. Sigurimi i shërbimeve të rezervave ndihmëse aFRR dhe mFRR të mjaftueshme, janë kruciale në këtë kontekst.

Parashikimi i kostove të shërbimeve ndihmëse është bërë mbi bazën e vlerave të realizuara një vit me përpara si dhe viteve tjera paraprake.

KOSTT kërkon që analizat të bëhen me shumë kujdes, duke mos e vënë në vështirësi kompaninë në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që ka ndaj ENTSO-E (që të mos vijë në pyetje aktivizimi i masave nga Shtojca 2 e MK), dhe gjithashtu ndaj Kodit të Rrjetit dhe procedurave të brendshme. Andaj, rikthehemi me të njëjtën kërkesë sa i përket shërbimeve ndihmëse e cila është paraqitur në vijim.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 4 nga 5

Tabela 3. Kosto e parashikuar e kapacitetit për shërbime ndihmëse për vitin 2025

KALKULIMI DHE KOSTOT PËR SHËRBIME NDIHMËSE TË RISHIKUARA aFRR DHE mFRR PËR VITIN 2025										
Kosto e kapacitetit në realizim për shërbime ndihmëse aFRR (±25 MW & ±40 MW) dhe mFRR në ngritje (+196 MW) dhe zbritje (-50 MW)										
Muaji	Kapaciteti (MW)	Kapaciteti (MW)	ditë/muaji	aFRR ngritje ±25 MW 9 orë 56.00 €/MW	aFRR zbritje ±25 MW 9 orë 60.00 €/MW	aFRR ngritje ±40 MW 15 orë 56.00 €/MW	aFRR zbritje ±40 MW 15 orë 60.00 €/MW	mFRR ngritje +196MW/h €/MW	mFRR zbritje -50MW/h €/MW	Gjithësej aFRR (9h*25 + 15h*40) + mFRR
Janar	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	1,242,420.48 €	156,240.00 €	4,365,360.48 €
Shkurt	25.0	40.0	28	352,800.00 €	378,000.00 €	940,800.00 €	1,008,000.00 €	1,122,186.24 €	146,160.00 €	3,947,946.24 €
Mars	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	1,200,131.52 €	189,720.00 €	4,356,551.52 €
Prill	25.0	40.0	30	378,000.00 €	405,000.00 €	1,008,000.00 €	1,080,000.00 €	1,255,968.00 €	188,640.00 €	4,315,608.00 €
Maj	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	1,300,750.08 €	194,928.00 €	4,462,378.08 €
Qershor	25.0	40.0	30	378,000.00 €	405,000.00 €	1,008,000.00 €	1,080,000.00 €	743,702.40 €	92,880.00 €	3,707,582.40 €
Korrik	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	785,991.36 €	95,976.00 €	3,848,667.36 €
Gusht	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	892,442.88 €	95,976.00 €	3,955,118.88 €
Shtator	25.0	40.0	30	378,000.00 €	405,000.00 €	1,008,000.00 €	1,080,000.00 €	681,609.60 €	92,880.00 €	3,645,489.60 €
Tetor	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	1,185,549.12 €	159,588.00 €	4,311,837.12 €
Nëntor	25.0	40.0	30	378,000.00 €	405,000.00 €	1,008,000.00 €	1,080,000.00 €	1,202,342.40 €	168,120.00 €	4,241,462.40 €
Dhjetor	25.0	40.0	31	390,600.00 €	418,500.00 €	1,041,600.00 €	1,116,000.00 €	1,242,420.48 €	183,396.00 €	4,392,516.48 €
Total (+ & -) SH.N				4,599,000.00 €	4,927,500.00 €	12,264,000.00 €	13,140,000.00 €	12,855,514.56 €	1,764,504.00 €	49,550,518.56 €
Total SH.N				9,526,500.00 €		25,404,000.00 €		14,620,018.56 €		

2. PROJEKTET KAPITALE

Në Raportin Konsultativ ZRrE ka refuzuar kërkesën e KOSTT për përfshirjen e projekteve të reja në Planin Investiv aktual. KOSTT qëndron në të njëjtin pozicion si në kërkesën e mëparshme për përfshirjen e projekteve të propozuara.

Siç e kemi theksuar edhe në dokumentet e mëparshme, këto projekte janë thelbësore për zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit të transmetimit, si dhe përkrahjen e ngarkesës, duke siguruar një furnizim më të besueshëm dhe efikas me energji për konsumatorët.

E kemi të qartë se në përputhje me rregullat dhe kërkesat e ZRrE, kërkesa jonë është e justifikueshme dhe e mbështetur nga dokumentacioni dhe Planet Zhvillimore dhe Investive të miratuara. Ne e vlerësojmë që ZRrE propozon shqyrtimin e këtyre projekteve gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik të radhës, por për KOSTT është shumë e rëndësishme që këto projekte të lejohen në këtë proces, duke pasur parasysh ndikimin pozitiv që ato do të kenë për konsumatorët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergetik.

Për këtë arsye, kërkojmë nga ZRrE që të rishqyrtojë propozimin e paraqitur në Raport Konsultativ dhe të merret parasysh kërkesa e KOSTT për aprovimin e këtyre projekteve.

Duke marrë parasysh natyrën dinamike të rrjetit të transmetimit si dhe nevojat dhe kërkesat si teknike ashtu edhe ligjore, rregullative dhe kontraktuale, KOSTT në vazhdim paraqet kërkesën për përfshirjen e shtatë projekteve të reja në këtë periudhë pesëvjeçare dhe ndryshimin e burimit të financimit për një projekt. Duhet theksuar se të gjitha këto projekte janë të aprovuara me Planin Zhvillimor Dhjetëvjeçar. Kërkesa e KOSTT është që të përfshihen në Planin Zhvillimor dhe Investiv Pesëvjeçar si realizim në vitin 2027.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 5</i>

Për financimin e këtyre projekteve KOSTT është në bisedime me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim të cilët janë të gatshëm të mbështesin KOSTT-in në këtë fazë të rëndësishme të zhvillimit me një kredi të butë.

PËRMBYLLJE

KOSTT shpreson se kërkesat e paraqitura do të shqyrtohen dhe aprovohen nga ZRrE gjithnjë duke pasur parasysh prioritetet, tendencat drejt një normalizimi dhe rrethanat e reja të krijuara në sektorin energjetik, stabilizimin e çmimeve të energjisë, sigurinë kombëtare dhe të energjisë, prioritetet për investime dhe së fundmi por jo nga rëndësia, benefitet që sjellin këto investime në interes të qytetarëve si përfitues fundor.